



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOZHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Fondi javor i orëve për edukatore

NUMËR:47/2007

DATË: 9.10. 2007

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr.1/2007, neni 29.2 të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT), nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim administrativ ka për qëllim caktimin e fondit të orëve të edukatoreve për një javë.

Neni 2

Fondi i orëve të edukatoreve për një javë është 40 (30+10)

Eduktorja duhet të jetë në punë të drejtëpërdrejtë me fëmijë 30 orë në javë, ndërsa 10 orë në punë indirekte (përgatitje për punë edukativo-arsimore, bashkëpunim me prindër, veprimtari kulturore etj).

Neni 3

Përfashtimet

1. Përfashtim nga orari i përcaktuar në nenin 2 mund të bëhet në këto raste specifike:
 - a) në mungesë të kuadrit profesional,
 - b) në mungesë të buxhetit ,
 - c) në mungesë të infrastrukturës së mjaftueshme.
2. Nëse edukatorja punon më tepër sesa orari i punës i përcaktuar në nenin 2 të këtij udhëzimi administrativ, për punën shtesë do të kompensohet .

Neni 4

Ndërrimet

Në institucionet parashkollore që kanë mundësi dhe kushte për punë të pandërprerë, edukatorët punojnë nga 6 orë, me ndërrime, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Fondi i orëve të edukatoreve me grupe parafillore(përgatitore)

Edukatoret që punojnë me grupe fëmijësh në paralele parafillore (në kuadër të shkollave) punojnë nga 5 orë punë të drejtpërdrejtë dhe 1 orë përgatitje për punë edukativo-arsimore, bashkëpunimin me prindër apo veprimtari kulturore, duke përcjellë dy grupe fëmijësh (5+1), për të cilat grupe vendos DKA.

Neni 6

Fondi i orëve në institucionet private

Orari i punës së edukatoreve në kopshte private përcaktohet në bazë të këtij Udhëzimi administrativ.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky UA hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.

Agim Veliu, ministër